

## NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS – Departamenti për krime të rënda, kolegji i përbërë nga gjyqtarët Xhevdet Abazi, kryetar, Driton Muharremi dhe Fillim Skoro, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Eroll Gashi, procesmbajtës, në çështjen penale kundër të akuzuarit Y.D. nga Prishtina, për shkak të veprës penale Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e substancave psikotrope dhe analoge nga neni 273 par.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), duke vendosur përkitazi me ankesën e Prokurorisë Themelore në Prishtinë, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, PKR.nr.165/2017 datë 19.06.2016, në seancën e kolegjit të mbajtur me 24.08.2016 mori këtë:

## A K T G J Y K I M

Me miratimin e ankesës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë, ndryshohet aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, PKR.nr.165/2017 datë 19.06.2016, vetëm sa i përket vendimit mbi dënimin me burg, ashtu që Gjykata e Apelit e Kosovës, të akuzuarit Y.D., për veprën penale për të cilën është shpallë fajtorë, e gjykon me dënim me burg efektiv në kohëzgjatje prej 8 ( tetë) muaj në të cilin dënim do t'i llogaritet edhe koha e kaluar në arrest shtëpiak prej datës 13.04.2017 deri me datë 19.06.2017 ndërsa dënimi me gjobë në shumë prej 1000 (njëmijë) euro i merret si i vërtetuar.

## A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Prishtinë, me aktgjykimin PKR.nr.165/2017 datë 19.06.2016, të akuzuarin Y.D., e ka shpallë fajtor për shkak të veprës Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e substancave psikotrope dhe analoge nga neni 273 par.1 të KPRK, për çka e ka gjykuar me dënim me gjobë në shumë prej 1000 € dhe dënim me kusht në kohëzgjatje prej 2 (dy) vite i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari në afat prej 3 (tre) viteve nuk kryen veprë të re penale. Në dënimin e shqiptuar do t'i llogaritet edhe koha e kaluar në arrest shtëpiak prej datës 13.04.2017 deri me datë 19.06.2017. Është obliguar që t'i paguajë shpenzimet e procedurës penale dhe 50 € në emër të paushallit gjyqësor. I shqiptohet dënimi plotësues-marrja e 2 paketimeve-qeseve me marihuanë me peshë prej 1 kg e 849 gr.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjor ankesë kanë ushtruar :

- Prokuroria Themelore e Shtetit në Prishtinë, për shkak të vendimit për dënim, me propozim që ankesa të aprovohet, aktgjykimi i kundërshtuar të ndryshohet ashtu që të akuzarës ti shqiptoi dënim më të lartë me burg.

-Mbrojtësi i të akuzuarit Y.D., av. Faik Hoxha, ka ushtruar përgjigje ne ankesën e prokurorisë, me propozim që ankesa të refuzohet dhe aktgjykimi i shkallës së parë të vërtetohet.

Prokuroria e Apelit me parashtrësën me shkrim PPA/I.nr.363/17 të datës 02.08.2017 ka propozuar që ankesa e Prokurorisë Themelore në Prishtinë të aprovohet.

Gjykata e Apelit e Kosovës, shqyrtoi të gjitha shkresat e kësaj çështje juridiko-penale, studioj aktgjykimin e kundërshtuar në përputhje me dispozitën e nenit 415 të KPPK-së, dhe pas vlerësimit të pretendimeve ankimore të cekura në ankesë gjeti se:

Ankesa e prokurorit është e bazuar.

Edhe pse aktgjykimi i shkallës së parë nuk ankimohet, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, megjithatë Gjykata e Apelit të njëjtin sipas detyrës zyrtare e shqyrtoi edhe në këtë aspekt, konstatoi se ai nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale e të cilat kishin me kushtëzuar anulimin e tij, si dhe shkelje të ligjit penal në dëm të akuzuarit. As gjendja faktike nuk qe objekt vlerësimi i kësaj Gjykate, ngase i akuzuari ka pranuar fajësinë dhe nuk është kontestuar me ankesë, prandaj aktgjykimin e ankimuar e vlerësoi vetëm në frymë të pretendimeve ankimore.

Duke vlerësuar çështjen përkitazi me vendimin për dënimin, Gjykata e Apelit vlerëson se pretendimet ankimore të prokurorisë se ky dënim nuk i përgjigjet peshës së veprës penale, përgjegjësisë penale të akuzuarit dhe rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale janë të bazuara. Kjo gjykatë pajtohet po ashtu me konstatimin e prokurorisë në ankesë se duke pasur parasysh peshën e veprës penale, mënyrën dhe rrethanat e kryerjes së veprës penale të lartcekur, rrezikshmërinë shoqërore të veprës penale dhe pasojat e kësaj vepre, nuk mund të arrihet qëllimi i dënimit.

Rrethanat e vlerësuara të cilat i ka konstatuar dhe vlerësuar gjykata e shkallës së parë, me rastin e shqiptimit të dënimit ndaj të akuzuarit Y.D., sipas vlerësimit të kësaj gjykate, nuk janë të natyrës së atillë që të ndikojnë që në rastin konkret të akuzuarit, për këtë vepër penale t'i shqiptohet një dënim kaq i butë - dënim me kusht, kur kihet parasysh peshë e veprës penale, rrezikshmëria shoqërore e veprës penale, mënyrat dhe rrethanat e kryerjes së veprës penale si dhe sasia e narkotikut në peshë mbi një kilogram ( 1849 gr), prandaj kjo gjykatë të akuzuarës i shqiptoi dënimin sikur se në dispozitiv të këtij aktgjykimi, me bindje se ky dënim është në proporcion me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarës, dhe se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me nenin 41 të KPRK.

Prandaj, nga arsyet e sipër cekura u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi e konform nenit 403 të KPP-së.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS  
PAKR.nr.374 /2017, datë 24.08.2017

Procesmbajtësja,  
Eroll Gashi

Kryetari i kolegjit- gjyqtari  
Xhevdet Abazi

Anëtarët e kolegjit:

2. Driton Muharremi \_\_\_\_\_

3. Have Haliti \_\_\_\_\_